



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 07.04.2015,
e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Vjollca Dibra – Ibrahimimi (LDK), Naime Osmani (LDK), Besa Rafuna (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Genc Sherifi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Qëndron Kastrati (LVV), Ylli Hoxha, shef i GP-së (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Shaip Shabani (PDK), Laura Zherka (PDK), Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Imer Rusinovci, shef i GP-së (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD) dhe Nenad Miladinoviq, përfaqësues i subjektit politik (GIS).

Munguan: Vlora Dumoshi (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Sofije Bunjaku (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Rita Begolli (AAK-LDD), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues. Ai fillimisht i njoftoi të pranishmit rreth ftesës nga DEMOS-i, si një partner me Komunën e Prishtinës, për një trajnim që e organizon nga dt. 14 - 16 prill, në Bogë të Rugovës, në hotel “Magra”, me temën “Financat e pushtetit lokal”. Është e nevojshme që të gjithë anëtarët e Kuvendit të marrin pjesë në këtë trajnim.

Para se të fillonin me diskutimet rreth in e pikave të rendit të ditës, **Visar Berisha**, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, propozoi që pika e gjashtë (*ashtu si është propozuar rendi i ditës*) - Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për ndërtimin e Pallatit Olimpik, të hiqet nga rendi i ditës, me arsyetimin që me Qeverinë e Republikës së Kosovës, të precizohet se cila pjesë e parcelës kadastrale saktësisht duhet të shpronësohet.

Kryesuesi, konstatoi se pika - Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për ndërtimin e Pallatit Olimpik, shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme.

Po ashtu kryesuesi njoftoi se shef i GP të LVV-së, do të jetë Qëndron Kastrati.

U konstatua se u miratua ky

R E N D D I T E:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Shqyrtimi i raportit përfundimtar përmbledhës buxhetor të Kryetarit të Komunës për vitin 2014;
3. Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2014 në vitin 2015;
4. Propozimvendimi për miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve në Planin rregullues "Arbëria 3";
5. Propozimvendimi për lënie në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kalabria";
6. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Republikës së Shqipërisë;
7. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndërtimin e objektit të IKAP-it;
8. Propozimvendimet për këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës me pronat në pronësi të personave fizikë/juridikë;
9. Marrëveshja e bashkëpunimit me HELVETAS;
10. Pyetje dhe përgjigje;
11. Të ndryshme.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, kërkoi nga kryesuesi që pika e dytë e rendit të ditës - Shqyrtimi i raportit përfundimtar përmbledhës buxhetor të Kryetarit të Komunës për vitin 2014, të diskutohet më vonë, për shkak të disa obligimeve që i ka Kryetari në periudhën e parë të mbledhjes. Njëherësh kërkoi që kjo të diskutohet në pjesën e dytë të seancës.

Për rendin e ditës diskutuan edhe Agim Gashi, Sami Hamiti, Sylejman Pireva, Shefki Gashi, Shemsi Veseli, Ylli Hoxha, Lirak Çelaj, Sadri Ramabaja dhe Qëndron Kastrati, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës, që ajo të diskutohet në pjesën e dytë të seancës.

Kryesuesi konstatoi se me shtatëmbëdhjetë (17) vota për dhe njëzet e dy (22) kundër: **Halim Halimi (LDK), Hazir Borovci (LDK), Sami Hamiti (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Naime Osmani (LDK), Vjollca Dibra-Ibrahimi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Flamur Shala (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Lirak Çelaj (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Shaip Shabani (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Laura Zherka (PDK), nuk u miratua propozimi që pika e dytë e rendit të ditës të shqyrtohet në pjesën e dytë të seancës.**

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Mirlinda Sopi bëri vërejtje në ekstraktin e dt. 24.2.2015 dhe në ekstraktin e dt. 11.3.2015, duke thënë se në hartimin e ekstraktit duhet të jetë një kujdes më i shtuar, që së paku ekstrakti të jetë i saktë.

Shaip Hajrizi bëri vërejtje në ekstrakt, duke cekur se për pyetjet e parashtruara nuk kthehet asnjë përgjigje. Kërkoi nga nënkryetari që kjo çështje të merret parasysh.

Muhamet Selmani bëri vërejtje në ekstrakt, duke thënë se nga pyetjet e parashtruara, nuk kanë marrë asnjë përgjigje, andaj kërkoj që për të gjitha pyetjet e parashtruara të jepen përgjigje.

Sadri Ramabaja bëri vërejtje, duke shtuar se në ekstrakt nuk po shënohen emrat e atyre të cilët votojnë kundër. Ai kërkoi që kjo të mos përsëritet në mbledhjet e ardhshme. Në ekstrakt thuhet se z. Pireva ka ngritur çështjen e bibliotekës "Hivzi Sylejmani", e që në fakt nuk ka të bëjë me ndërtimin e objektit të bibliotekës, andaj duhet të jetë: *"... për ngecje të defekteve të procedurave joligjore, jo korrekte, të pranimit-dorëzimit të ndërtimit të atij objekti"*.

Lirijeta Rexhepi bëri vërejtje në ekstrakt, lidhur me moskthimin e përgjigjeve në pyetjet e shtruara. Ajo kërkoi që përgjigjet të kthehen me shkrim.

Shiqeri Spahiu po ashtu bëri vërejtje lidhur me moskthimin e përgjigjeve, dhe kërkoi që përgjigjet të kthehen me shkrim.

Me shumicë votash, dy (2) abstenime (Fadil Gashi dhe Imer Rusinovci), u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara të Kuvendit.

Pika e dytë

Shqyrtimi i raportit përfundimtar përmbledhës buxhetor të Kryetarit të Komunës për vitin 2014.

Lidhur me shqyrtimin e raportit përfundimtar përmbledhës buxhetor të Kryetarit të Komunës për vitin 2014, të pranishmit i informoi Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës.

Lidhur me këtë diskutuan Sami Hamiti, shef i GP i LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Muhamet Selmani, në emër të GP të PDK-së, Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së, Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së, Feti Mehdiu, shef i GP të PD-së, Abetare Fazliu, në emër të GP të LB-së dhe Nenad Miladinoviç, përfaqësues i subjektit politik GIS. Diskutuan edhe Sokol Krasniqi, Ylli Hoxha, Hysen Durmishi, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, Agim Gashi, Bekim Gashi, Sadri Ramabaja, Shiqeri Spahiu, Kreshnik Ahmeti, Shemsi Veseli, Dardan Sejdiu, nënkryetar, Mirlinda Sopi, Hazir Borovci, Bardha Dida - Rogova, Merita Surkishi, Sylejman Pireva dhe Hatixhe Pupovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi e hodhi raportin në votim.

Kryesuesi konstatoi se me gjashtëmbëdhjetë (16) vota për dhe me njëzet e katër (24) kundër : Halim Halimi, Hazir Borovci, Sami Hamiti, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Sokol Krasniqi, Bekim Gashi, Naime Osmani, Vjollca Dibra- Ibrahim, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Shiqeri Spahiu, Besa Rafuna, Lirak Çelaj, Blerand Stavileci, Shaip Shabani, Muhamet Selmani, Lirie Avdiu, Laura Zherka dhe Lirijeta Rexhepi), nuk u miratua raporti përfundimtar përmbledhës buxhetor i Kryetarit të Komunës për vitin 2014.

Pika e tretë

Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2014 në vitin 2015.

Për këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi hapi diskutimin.

Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, në pika të shkurtra paraqiti arsyetimin për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2014 në vitin 2015.

Lirak Çelaj dhe Muhamet Selmani, propozuan që kjo pikë të shtyhet për diskutim në njërin nga mbledhjet e radhës, me arsyetimin që ky propozimvendim të jetë më i detajzuar dhe më i kompletuar, që të përfshijë edhe disa projekte të tjera që janë më se të domosdoshme.

Shefki Gashi propozoi që të ndahet një shumë e mjeteve buxhetore për një projekt rreth furnizimit me ujë për disa fshatra të komunës, siç janë fshati Mramor, Keqekollë, Marevc etj.

Kimet Zeqa propozoi që në emër të grupit të grave, të ndahen mjete edhe për aktivitetet e gruas.

Imer Rusinovci propozoi që të ndahen mjete financiare për ndërtimin e rrugës Keqekollë - Nishevc, e cila vazhdon deri në Prapashticë.

Sylejman Pireva, propozoi mundësinë e specifikimit për ndarje të mjeteve financiare për financim të librit.

Sadri Ramabaja e përkrahu mendimin e nënkryetarit, duke shtuar se ka një predisponim pozitiv, që në parim çështja të shkojë, ndërkaq këto kërkesa të përfillen, të jenë të detajizuara dhe të sillen nesër.

Për bartjen e buxhetit diskutuan edhe: **Dardan Sejdiu, Visar Berisha, Sami Hamiti, Qëndron Kastrati, Islam Pacolli, Imer Rusinovci, Feti Mehdiu, Abetare Fazliu, Agim Gashi, Naime Osmai, Ylli Hoxha, Abit Kastrati, Hazir Borovci, Hatixhe Latifi – Pupovci, Fadil Gashi, Shaip Hajrizi dhe Bekim Gashi**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi propozoi një pauzë prej 40 minutash, që shefat e GP të arrijnë ndonjë marrëveshje rreth unifikimit të kërkesave të tyre.

Dardan Sejdiu i njoftoi të pranishmit se, në konsultim e sipër me shefat e GP-ve, u pajtuan që, të premten, më 10.04.2014, të vazhdojë seanca, me ç’rast edhe do të sillen detajet dhe specifikat sipas diskutimeve, ku dhe do të trajtohen ato kërkesa që u paraqitën.

Vazhdimi i mbledhjes më 10.04.2015, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Naime Osmani (LDK), Besa Rafuna (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Genc Sherifi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinovci, shef i GP-së (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP) dhe Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS).

Munguan: Vlora Dumoshi (LDK), Vjollca Dibra – Ibrahim (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Blerand Stavileci (PDK), Shaip Shabani (PDK), Shemsi Veseli (PDK) dhe Remzi Pacolli (AKR).

Pika e tretë (vazhdimi)

Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2014 në vitin 2015.

Dardan Sejdiu tha se në bashkëpunim me shefat e grupeve parlamentare dhe me Drejtorinë e Financave dhe Pronës, jemi pajtuar për pikat rreth të cilave kemi pasur një mospajtim lidhur me disa projekte, të cilat u propozuan nga anëtarët e Kuvendit.

Visar Berisha, – drejtori i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, dha sqarime shtesë rreth disa pikave të propozuara.

Për propozimvendimin diskutuan: Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Qendron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Muhamet Selmani, në emër të GP të PDK-së, Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së, Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së, Kimet Zeqa, në emër të GP të PD-së, Abetare Fazliu, në emër të GP të LB-së, Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik PF, Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP, Nenad Miladinoviç, përfaqësues i subjektit politik GIS, Ajnishahe Azemi dhe Hysen Durmishi, drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatua se me shumicë votash, dhe me një (1) abstenim, u miratua Vendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2014 në vitin 2015.

Pika e katërt

Propozimvendimi për miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve në Planin rregullues “Arbëria 3”;

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve në Planin rregullues “Arbëria 3”, në pika të shkurtra informoi Liburn Aliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Ardita Byci - Jakupi, përfaqësuese nga kompania projektuese “Urban Plus”. Në mënyrë elektronike bëri prezantimin e këtij plani, duke elaboruar disa nga komponentët kryesore të tij.

Lidhur me këtë propozimvendim diskutuan: Feti Mehdiu, Shiqeri Spahiu, Laura Zherka, Qëndron Kastrati, Islam Pacolli, Imer Rusinovci, Kimet Zeqa, Abetare Fazliu, Visar Arifaj, Shefki Gashi, Ajnishahe Azemi, Ylli Hoxha, Muhamet Selmani, Sami Hamiti, Ibrahim Mehmetaj, Mustafë Krasniqi, Lirak Çelaj dhe Agim Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin.

Kryesuesi konstatoi se me njëzet e dy (22) vota për dhe me gjashtëmbëdhjetë (16) vota kundër: Halim Halimi, Hazir Borovci, Sami Hamiti, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Sokol Krasniqi, Bekim Gashi, Naime Osmani, Vjollca Dibra- Ibrahim, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Shiqeri

Spahiu, dhe katër abstenime: Lirak Çelaj, Muhamet Selmani, Laura Zherka dhe Shaip Shabani, u miratua Vendimi për miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve në Planin rregullues "Arbëria 3" në Prishtinë.

Pas përfundimit të pikës së katërt të rendit të ditës, nga kryesuesi u propozua një pauzë njëorëshe.

Me të filluar mbledhja, **Lirak Çelaj** ngriti një shqetësim rreth konfliktit të ndodhur gjatë kohës së pauzës, në mes të asamblistit **Muhamet Selmani** dhe **Liburn Aliu**, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, me ç'rast propozoi që mbledhja të mos vazhdojë. Të njëjtin mendim shprehu edhe **Sami Hamiti**.

Rreth konfliktit diskutuan edhe **Qëndron Kastrati, Agim Gashi dhe Dardan Sejdiu**.

Duke pasur parasysh gjendjen e krijuar, kryesuesi propozoi që mbledhja të ndërpritet dhe mbetet të vazhdojë në njërën nga ditët e ardhshme.

Vazhdimi i mbledhjes më 27.4.2015, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahimimi (LDK), Naime Osmani (LDK), Besa Rafuna (LDK), Merita Surkishi (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Genc Sherifi (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Ylli Hoxha, (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Sylejman Pireva (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Shaip Shabani (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Laura Zherka (PDK), Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinovci, shef i GP-së (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP) dhe Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS).

Munguan: Flamur Shala (LDK), Lirie Avdiu (PDK), Remzi Pacolli (AKR) dhe Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB).

Para se të fillonin me diskutimet për pikën në vazhdim, **Kimet Zeqa** i njoftoi të pranishmit se më 12 maj 2015, në oborrin e objektit të Komunës, do të jetë aktiviteti i radhës së Grupit të grave për dhënien e gjakut, andaj kërkoj që këtij aksioni të vullnetit të mirë t'i bashkëngjiten edhe anëtarët e tjerë të Kuvendit.

Faqe 7 nga 12

Lirak Çelaj, për shkak të situatës së krijuar në mes të anëtarit të PDK-së dhe drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, paraqiti kërkesën e këtij subjekti për shkarkimin e drejtorit Liburn Aliu, dhe bëri të ditur se çdo pikë që vjen nga kjo drejtori, nuk do ta debatojmë dhe as nuk do ta votojmë.

Njëherësh ai kërkoi që të rishikohen raportet kontraktuese me këtë kompani, e cila ka bërë hartimin e planit rregullues të lagjes “Arbëria 3”.

Sami Hamiti tha se edhe GP i LDK-së e ka analizuar situatën pas ndërprerjes së mbledhjes së tretë, dhe plotësisht jemi dakord që kërkesa për shkarkimin e z. Liburn Aliu, të jetë kërkesë edhe e GP të LDK-së. Po ashtu jemi dakord që çdo pikë që vjen nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, që për shkak të mos reflektimit të ekzekutivit ndaj situatës së krijuar në ballafaqim me Kuvendin, nuk do të debatohet dhe as nuk do të votohet.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, tha se ky rend i ditës është votuar, andaj propozoj që të vazhdohet me diskutim të pikave dhe mund të votohet për ose kundër për hedhje në diskutim publik.

Pika e pestë

Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes “Kalabria”.

Para se të fillonin me prezantimin e Planit rregullues të lagjes “Kalabria”, **Ylli Hoxha** ngriti një shqetësim rreth kërkesës për dorëheqjen e Liburn Aliut, duke thënë se, kërkesa për dorëheqje është krejtësisht politike. Kjo është manifestuar edhe përmes organizatave të ndryshme ekonomike, të cilat i janë rreshtuar kërkesës së Sami Hamitit. Por, është e pa pranueshme për qytetin e Prishtinës, sepse Liburn Aliu është shtyllë e fortë e luftimit të krimit të organizuar në këtë qytet.

Lidhur me Propozimvendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes “Kalabria”, përfaqësuesi i kompanisë “Vizioni Plus”, **Ilir Gjinolli**, në mënyrë elektronike, paraqiti ndryshimin dhe plotësimin e këtij plani, duke i elaboruar disa nga komponentët kryesor të këtij plani.

Pas prezantimit të planit nga përfaqësuesi i kompanisë, **Kryesuesi** hapi diskutimin.

Për këtë temë diskutuan: Visar Arifaj, Laura Zherka, Feti Mehdiu, Ylli Hoxha, Qëndron Kastrati, Sylejman Pireva dhe Shemsi Veseli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve, Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin.

Kryeuesi konstatoi se me njëzet (20) vota për dhe njëzet e dy (22) kundër: Halim Halimi, Hazir Borovci, Sami Hamiti, Vlora Dumoshi, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Sokol Krasniqi, Bekim Gashi, Naime Osmani, Vjollca Dibra- Ibrahim, Hasime Krasniqi, Ajnishahe Azemi, Merita Surkishi,

Flamur Shala, Shiqeri Spahiu, Besa Rafuna, Lirak Çelaj, Blerand Stavileci, Muhamet Selmani, Laura Zherka, dhe një (1) abstënim, nuk u miratua Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kalabria".

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me Propozimvendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Republikës së Shqipërisë, arsyetimin për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale e paraqiti Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës.

Për këtë pikë diskutuan: Sami Hamiti, Qëndron Kastrati, Lirak Çelaj, Sofije Bunjaku, Rita Begolli, Feti Mehdiu, Visar Arifaj, Cuneyd Ustaibo, duke i dhënë përkrahje këtij propozimvendimi.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Republikës së Shqipërisë.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndërtimin e objektit të IKAP-së

Lidhur me Propozimvendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndërtimin e objektit të IKAP-së, arsyetimin për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale e paraqiti Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës.

Për këtë pikë diskutuan: Sami Hamiti, Ylli Hoxha, Lirak Çelaj, Mirlinda Sopi, Imer Rusinovci, Feti Mehdiu dhe Nenad Miladinoviqi, duke i dhënë përkrahje këtij propozimvendimi.

Visar Arifaj, u shpreh i rezervuar, duke cekur se këtë propozimvendim ne nuk do ta përkrahim për votim.

Me shumicë votash, një (1) kundër (Visar Arifaj), u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndërtimin e objektit të IKAP-së.

Pika e tetë

Propozimvendimet për këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës me pronat në pronësi të personave fizikë/juridikë.

Për Propozimvendimet për këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës me pronat në pronësi të personave fizikë/juridikë, arsyetimin e paraqiti Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës.

Lidhur me propozimvendimet diskutuan: Shiqeri Spahiu, Qëndron Kastrati, Shemsi Veseli, Sofije Bunjaku, Fadil Gashi, Feti Mehdiu, Visar Arifaj, Cuneyd Ustaibo, Sami Hamiti dhe Sadri Ramabaja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi i hodhi në votim propozimvendimet një nga një.

1. Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën në pronësi të Bashkësisë Islame.
2. Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën në pronësi të Petrit Sherif Bajgorës.
3. Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën në pronësi të Rexhë Salih Shoshit.

Pika e nëntë

Marrëveshja e bashkëpunimit me HELVETAS.

Lidhur me marrëveshjen e bashkëpunimit me HELVETAS, të pranishmit i informoi Fitore Pacolli, shefe e Kabinetit të Kryetarit të Komunës.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Marrëveshja me HELVETAS.

Pika e dhjetë

Pyetje dhe përgjigje

Kimet Zeqa paraqiti një shqetësim rreth personave me aftësi të kufizuara, të shoqatës "Handikos", me ç' rast kërkoi nga Kryetari, apo nënkryetari, që të kenë një qasje me atë kategori, të shkojnë t'i vizitojnë, sidomos përfaqësuesit e Drejtorisë së Shëndetësisë, pasi ata i kishin disa kërkesa për disa shërbime shëndetësore. Me drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë kemi diskutuar, dhe ai ka premtuar se kërkesat e tyre do të realizohen në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në QMF në lagjen "Kodra e Diellit".

Njëherësh kërkoi të dijë se cilat linja të trafikut urban mundësojnë transportin falas për pensionist, a është linja nr. tre (3) apo linja nr. katër (4).

Muhedin Nushi, drejtor i Drejtorisë së Administratës, tha se të dy linjat e trafikut urban (linjat 3 dhe 4) e mundësojnë transportin falas për kategorinë e pensionistëve. Linjat e operatorëve privatë nuk mundësojnë transport falas.

Kryesuesi i informoi të pranishmit se Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), tash e tutje do të jetë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të Ylli Hoxhës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi që Qëndron Kastrati të jetë anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e njëmbëdhjetë

Të ndryshme

Merita Surkishi, pyetje për Drejtorinë e Inspeksionit.

-Pyetja e parë ka të bëjë me aksionin e fundit të Komunës së Prishtinës për rrënimin e shtëpive të vjetra, gjëja se paraqesin rrezikshmëri për qytetarët. Pyes se në çfarë baze është bërë vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë.

Lidhur me këtë, dua të paraqes një rast, që ka të bëjë me rrënimin e një shtëpie në lagjen "Tophane", në rrugën "Lidhja e Prizrenit". Kjo shtëpi vërtet ka qenë e pa banuar 2-3 vitet e fundit, mirëpo nuk konsiderohet shtëpi me rrezikshmëri, pasi që ka qenë shtëpi dykatëshe, e ndërtuar me blloka, gjë që e argumentoj me të gjitha dokumentet që i posedoj unë nga pronari i shtëpisë. Si ka mundur të bëhet rrënimi i shtëpisë së pronarit legjitim dhe ekzistues, pa paralajmërim dhe pa pëlqimin e pronarit?

- Pyetja e dytë, ka të bëjë me banorët e lagjes "Dardania", në rrugën "Ilaz Kodra", saktësisht ndërtesa SU 6/6, që hallin e tyre ta paraqesin në Kuvend, rreth dhënies së lejes të një bodrumi të ndërtesës për zhvillim të biznesit. Banorët ankohen se nuk i plotëson kushtet, pasi që nuk posedon as parking, përveç kushteve të tjera. Gjithashtu banorët ankohen se edhe gjatë punës ka pasur shkelje, gjë që e ka vërtetuar edhe Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor. Pronari ka bërë prerjen e konstruktit bazë të shtyllave të ndërtesës dhe garazheve, duke rrezikuar këtu jetën e banorëve. Gjithashtu shkelje tjetër është bërë me mbylljen e dy hapësirave të ventilimit me pllaka të betonit. Këta banorë kërkojnë që të respektojnë vlerësimin e Ministrisë, në mënyrë që ky objekt të kthehet në gjendjen e mëparshme. Për këtë shqetësim, kam peticionin e gjithë banorëve të lagjes.

Rita Begolli, propozoi që Komuna e Prishtinës ta bëjë një memorandum bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës, gjegjësisht që studentët e dalluar të Universitetit të

Prishtinës të lëmenjve të ndryshëm, ta kenë obligative mbajtjen e praktikës në Komunën e Prishtinës, në drejtori të caktuara.

Naime Osmani ngriti shqetësimin e saj lidhur me rrënimin e objekteve dhe largimin e punëtorëve nga puna. Rast konkret kemi në BVI, ku është larguar personi i cili ka kontratë pune edhe për dy vitet e ardhshme. Shtëpia ku ka banuar ai, mendoj se nuk ka qenë 60 vjeçare, por personi është 60 vjeçar dhe drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit e largon nga puna dhe në atë vend të punës e dërgon motrën e tij.

Qëndron Kastrati tha se përderisa jam edhe anëtarë i Komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Banesore, ose ish-BVI-ja, kanë qenë dy persona të zgjedhur nga Bordi, që mandati i tyre është trevjeçar. Edhe ligjërisht, Ligji për ndërmarrjet publike e parasheh që gjatë fundit të mandatit, konkursi duhet të jetë i hapur dhe të ndodh prapë. Është e njëjta logjikë sikur ne që jemi asamblistë, e kemi mandatin katërvjeçar, edhe për me mundur me fituar një mandat tjetër, duhet me iu parashtruar të njëjtit rast, pra nuk ka qenë përjashtim i atyre nga puna. Bordi ka konstatuar që vazhdimi i mandatit të tyre ka qenë i jashtëligjshëm, njëjtë sikur ka ndodhur me një kryeshef të një ndërmarrje tjetër, që vendimi i parë i gjykatës, jo i plotfuqishëm, ka qenë se procedurat për vazhdimin e mandatit kanë qenë në kundërshtim me ligjin, edhe në kuadër të kësaj ka ndodhur veprimi në fjalë. Sa i përket motrës së Xhelal Sveçlës, nuk po e marr me siguri, por nuk kam dëgjuar dhe nuk besoj se është e vërtet dhe, me sa e di unë, nuk ka motër Xhelal Sveçla.

Mbledhja mbaroi në orën 13:35.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.